



V E N D I M

Nr. 43 Date 11.04. 2008

PER
FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE “MUSO HEC
QYTEZE” SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa a, dhe 8, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa a, dhe nenit 38, te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s”, miratuar me Vendimin nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.04.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Muso Hec Qyteze” Sh.p.k., per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit dhe prodhimit te energjise elektrike nga Hec Qyteze,

Vendosi

1. Të filloje procedurat per licensimin e shoqerise “Muso Hec Qyteze” Sh.p.k. ne aktivitetin e ndertimit dhe prodhimit te energjise elektrike nga Hec Qyteze.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta